

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria M&I SISTEMS, KO SHPK NOVI SAD me seli të regjistruar në Industrijska 3b, Novi Sad, Serbi, dorëzuar nëpërmjet Elena Dimova-Ivanoska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 05.05.2025, miratoi

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin M&I SISTEMS, KO SHPK NOVI SAD fiton kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi NPS NDËRMARRJE PËR KËSHILLIM DHE SHËRBIME NË INFORMATIKË SHPK, BEOGRAD, Republika e Serbisë me seli të regjistruar në Bulevardi Marshal Tolbuhin 44, 11070, Novi Beograd, Serbi, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë tarifë administrative për njoftim për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në vlerë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 04.04.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës iu dorëzua njoftimi për përqendrim nga M&I SISTEMS, KO SHPK NOVI SAD, me të cilin M&I SYSTEMS, CO DOO NOVI SAD do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi NPS NDËRMARRJE PËR KËSHILLIM DHE SHËRBIME NË INFORMATIKË SHPK, BEOGRAD, Republika e Serbisë me seli të regjistruar në Bulevardi Marshal Tolbuhin 44, 11070, Novi Beograd, Serbi.

Komisioni hapi hetimin e Njoftimit në ditën e marrjes dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara nga Njoftimi për përqendrim dhe shtojcat përkatëse konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

-M&I SISTEMS, KO SHPK NOVI SAD është e regjistruar për të ofruar shërbime konsulence në lidhje me menaxhimin dhe mënyra të tjera të menaxhimit. Aktiviteti kryesor përfshin ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e produkteve, implementim, shërbime teknologjike, konsulencë dhe mbështetje (zgjidhje softuerike, transformime digjitale dhe IT konsulting).

M&I SYSTEMS, CO SHPK NOVI SAD është në pronësi të Seyfor, a.s., shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Çekisë. Seyfor a.s. ka shoqërinë e mëposhtme të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

-Shoqëri për shërbime KVANTOKS TEKNOLOGJI SHPKNJP Shkup me NUAS 7400292, me adresë në Shën Kirili dhe Metodi nr.3, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe veprimtari të regjistruar – Programim kompjuterik (“Kvantoks Teknologji”).

Konkretisht, Kvantoks Teknologji kryen zhvillim, outsourcing të proceseve të biznesit, zhvillim individual të softuerit, optimizim të transportit dhe fintech softuer.

M&I SISTEMS nuk ka shoqëri të lidhur të regjistruar drejtpërdrejt në Maqedoninë e Veriut, por ofron shërbime online ndërkufitare për klientët në Maqedoninë e Veriut.

-NPS NDËRMARRJE PËR KËSHILLIM DHE SHËRBIME NË INFORMATIKË SHPK, BEOGRAD, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga Beogradi, e cila ka si veprimtari programimin kompjuterik. Shërbimet e tyre përfshijnë projektimin e arkitekturave të reja të sistemeve të informacionit, implementimin e strategjive omni-kanale, automatizimin e proceseve dhe integrimin e zgjidhjeve të reja me sistemet ekzistuese. NPS është pjesë e Noventiq¹, një ofrues kryesor i zgjidhjeve dhe shërbimeve për transformim digjital dhe siguri kibernetike për tregjet në zhvillim.

NPS NDËRMARRJE PËR KËSHILLIM DHE SHËRBIME NË INFORMATIKË SHPK, BEOGRAD në Republikën e Maqedonisë së Veriut realizon të ardhura përmes ofrimit të shërbimeve IT, por nuk ka një shoqëri të lidhur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

¹ NPS është në pronësi shumicë të SAGA-s, e cila nga ana tjetër është në pronësi të Noventiq.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ